



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i dosjes: KSC-BC-2020-04

Vendos: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 10 qershor 2020

Gjuha: Anglishte

Titulli i dosjes: Caktim i vendit të zhvillimit të procedurës në shtetin pritës

Klasifikimi: Konfidencial dhe *ex parte*

VENDIM

për caktimin e vendit të zhvillimit të procedurës në shtetin pritës

Autoriteti caktues:

Kryetarja e Dhomave të Specializuara

Gjykatës i procedurës paraprake:

Gjykatës Nikola Giju

Zyra e Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në përputhje me nenin 3(6) dhe (8)(a) dhe (d) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), nenin 3 të Marrëveshjes me Shtetin Pritës dhe rregullën 82(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim për caktimin e vendit të zhvillimit të procesit në shtetin pritës lidhur me procedimin e nisur në bazë të nenit 38(4) të Ligjit dhe rregullës 86 të Rregullores, për të gjitha procedurat dhe çështjet e tjera në lidhje me dhe që dalin nga ai procedim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 1 janar 2017 hyri në fuqi *Marrëveshja midis Mbretërisë së Holandës dhe Republikës së Kosovës për Vendosjen në Holandë të Institucionit Gjyqësor të Specializuar të Zhvendosur të Kosovës* (“Marrëveshja me Shtetin Pritës”).

2. Më 14 shkurt 2020, Prokurori i Specializuar njoftoi Kryetaren për procedimin që do të niste në bazë të rregullës 38(4) të Ligjit dhe rregullës 86(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”), dhe bëri kërkesë për caktimin e një gjykatësi të procedurës paraprake në përputhje me nenin 33(1)(a) të Ligjit.

3. Në të njëjtën ditë, Kryetarja nxori “Vendim për caktimin e gjykatësit të procedurës paraprake”,¹ me të cilin caktoi gjykatësin Nikola Giju që të kryente detyrat e gjykatësit të procedurës paraprake lidhur me procedimin në bazë të nenit 38(4) të Ligjit dhe rregullës 86(2) të Rregullores.²

II. DISPOZITAT LIGJORE PÛRKATËSE

¹ KSC-BC-2020-04/F00001.

² KSC-BC-2020-04/F00001, f. 2-3.

4. Kryetarja vë në dukje nenin 3(6), dhe (8)(a) dhe (d) të Ligjit, nenin 3 të Marrëveshjes me Shtetin Pritës dhe rregullën 82(3) të Rregullores.

5. Në nenin 3(6) të Ligjit thuhet se Dhomat e Specializuara kanë seli në Kosovë. Siç përcaktohet me anë të një marrëveshjeje ndërkombëtare me shtetin pritës, Dhomat e Specializuara po ashtu kanë seli edhe në shtetin pritës jashtë Kosovës [...].

6. Në nenin 3 të Marrëveshjes me shtetin pritës thuhet se Institucioni Gjyqësor i Specializuar i Zhvendosur i Kosovës ka seli në shtetin pritës.

7. Neni 3(8)(a) i Ligjit autorizon Kryetaren që të kërkojë që të bëhet caktimi i vendit të zhvillimit të procedurës në shtetin pritës për shqyrtim gjyqësor, cilëndo pjesë të shqyrtimit gjyqësor, ose ndonjë fazë apo disa fazave të caktuara të procesit penal sipas këtij Ligji, për arsye të administrimit të duhur të drejtësisë dhe sigurisë.

8. Në nenin 3(8)(d) të Ligjit gjithashtu thuhet se në rastin kur vendoset caktimi i vendit të zhvillimit të procedurës në shtetin pritës, Kryetari [...] nxjerr vendim administrativ për caktimin e vendit të zhvillimit të procedurës, apo të ndonjë pjese apo faze të saj, në shtetin pritës dhe urdhëron të gjitha hapat e nevojshëm për zbatimin e këtij vendimi”.

III. VENDI I ZHVILLIMIT TË PROCEDURËS

9. Duke marrë parasysh parashtrimin e Prokurorit të Specializuar³ dhe veprimtarinë e tij hetimore në kryerje e sipër, Kryetarja gjykon se situata aktuale e sigurisë dhe administrimi i duhur i drejtësisë e bëjnë të domosdoshëm caktimin e vendit të zhvillimit të procesit në shtetin pritës. Ky ndryshim i vendit bëhet në lidhje me procedimin në këtë rast në bazë të nenit 38(4) të Ligjit dhe rregullës 86 të Rregullores, si edhe me të gjitha procedurat dhe çështjet e tjera që lidhen me ose dalin nga ai procedim. Kjo siguron kryerje efikase, efektive dhe të sigurt të këtyre procedurave.

³ KSC-BC-2020-04/F00002, para. 3.

IV. KLASIFIKIMI I VENDIMIT

10. Duke qenë se ka të bëjë me parashtrime të cilat aktualisht janë të klasifikuara si konfidenciale dhe duke mbajtur parasysh faktin që hetimet e Prokurorit të Specializuar dhe procedura para gjykatësit të procedurës paraprake ende kanë statusin konfidencial dhe *ex parte*, ky vendim ka të njëjtin status të klasifikimit. Në përputhje me rregullat 82-84 të Rregullores, ky vendim mund të riklasifikohet në një datë të mëvonshme në rast se dhe atëherë kur nuk ekzistojnë më arsyet për klasifikimin aktual të sa më lart.

PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA, KRYETARJA NË VIJIM

CAKTON vendin e zhvillimit të procesit lidhur me procedimin në këtë rast në bazë të nenit 38(4) të Ligjit dhe rregullës 86 të Rregullores, si dhe me të gjitha procedurat në lidhje me dhe që dalin prej këtij procedimi, në vendin pritës; dhe

KËRKON prej Administratores që të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për zbatimin e këtij vendimi.

_____/nënshkrim/____

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara

E mërkurë, 10 qershor 2020

Në Hagë, Holandë.